

# **THIRRJA PËR SHPREHJE INTERESI: Shërbim konsulence për “Hartëzimin e Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor dhe krijimin e Regjistrit Kombëtar”**

## **Pyetje/Përgjigje (FAQ)**

### **1. A mund të aplikoj individualisht apo në ekip/grup?**

Çdo aplikim duhet të jetë individual dhe qe lidhet me rolin e caktuar të ekspertit. Ekspertët mund të aplikojnë në grup, por kontrata do të jetë individuale dhe secili ekspert (1, 2, dhe 3) duhet të dërgojë aplikimin e tij/saj.

### **2. Aplikimet dorëzohet elektronikisht apo dorazi pranë zyrave të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)?**

Për të mos paragjykuar kandidatët mbi bazën e propozimit financiar, aplikimet dorëzohen vetëm dorazi pranë zyrës së Protokollit të AKKSHI-së dhe ne secilin zarf përfshihet një letër motivimi, metodologjia, kalendari i aktiviteteve, dhe CV-ja në anglisht (Zarfi/Dosja 1), dhe propozimi financiar në zarf të mbyllur (Zarfi/Dosja 2), siç përcaktohet në thirrje.

### **3. Sa ditë pune ka në dispozicion çdo ekspert/konsulent?**

Çdo ekspert ka në dispozicion për të kryer detyrat e caktuara në Termat e Referencës (ToR) një kohë prej 25 ditësh pune, e cila nuk duhet të kalojë periudhën e angazhimit. Gjithësesi, çdo ekspert e përcakton vetë në metodologjinë dhe propozimin financiar numrin e ditëve në të cilat do të kryejë detyrat e caktuara.

### **4. A ka një format të caktuar për propozimin financiar?**

Jo, nuk ka një format specifik dhe jeni të lirë të përdorni formatin tuaj individual.